Status Sol	A : 17	mbushja e ujit të ngrohtë pajisja solare (0 = nuk është e nevojshme / 1 = e nevojshme)	Pyetja për „bllokimin“të mbushjes së akumuluesit dhe funksionit antilegional



Par. Nr. BM	Par. Nr. BM-Solar	Emërtimi	Vendi për programim		Programimi i punës
SOL 01	P 01	Diferenca e e ndezjes	8K	30K	10K
SOL 02	P 02	Diferenca e ndaljes	3K	20K	5K
SOL 03	P 03	Funksioni mbrojtës i kolektor.	0	1	0
SOL 04	P 04	Temp. kritike e kolektorëve	90°C	150°C	110°C
SOL 05	P 05	Temp. maks. e kolektorëve	100°C	150°C	130°C
SOL 06	P 06	Temp. maks. akumuluese	15°C	90°C	60°C
SOL 07	P 07	Kategroz. i akumuluesit-> BM	0	8	0
SOL 08	P 08	Regjs. i sasisë së nxehtësisë	0	2	0
SOL 09	P 09	të P08 = 1 vlera e impulsave të P08 = 2 sasia qarkulluese	0 l/Imp 0 l/min	99l/Imp 99l/min	1 l/Impuls 1 l/min
SOL 10	P 10	Zgjedhja niveli mesatar	0	1	1
SOL 11	P 11	Busspeisung	0	2	2
SOL 50	P 50	Rele testi	1	5	1

Teknika e rregullimit (rregullatorit) Solari SM 2

Moduli solar SM 2

- **Moduli shtesë SM 2 për pajisjet me një dhe dy qarqe;**
- **Mundësi e përzgjedhjes së 11 konfigurimeve (konfiguracioneve);**
- **Mundësia e komandimit “by pass” për pajisje të mëdha;**
- **2 fusha të kolektorëve (komandimi: lindje-perëndim);**
- **Dirigjimi i pompës përmes rregullimit të numrit të rrotullimeve**
- **Moduli BM që mund të integrohet apo me kutinë e murit të shfrytëzohet si një teledirigjues;**
- **Kombinohet me rregullatorin e kaldajës dhe të vlerave të djegies;**
- **Kursim më i madh i energjisë përmes mbushjes (akumulatorit) inteligjent;**
- **Identifikimi i sasisë së nevojshme të energjisë;**
- **Funksioni mbrojtës i kolektorëve;**
- **Tregues i vlerave të reale dhe atyre momentale në kombinim me modulin BM apo BM Solar;**
- **Teknika e lidhjes me 5 spina.**


170 ± 0,3
85 ± 0,2
43,3 ± 0,25
∅14 + 0,2
1
A1
A2
A3
11,7 ± 0,25
22,3 ± 0,2
100 ± 0,3
--- GND
--- +eBus
--- -eBus
Klemmenbelegung
1
16
Kyçja
SKP1
A1
A3 / A4
A2
L1 --- N --- PE --- N --- PE --- L --- N --- PE --- L --- PE --- A(A3) --- Z(A4) --- N --- N --- PE --- L ---
1
12
SFS1
SFK1
E1
E2
E3
eBus
GND --- SPF1 --- GND --- SFK1 --- GND --- E1 --- GND --- E2 --- GND --- E3 --- - eBus --- + eBus ---

Konfigurimi i pajisjes	Pajisja	Numri i akum-uluesve solar	Numri i fushave të kolektorëve
1	Pajisja njëqarkore	1	1
2	Pajisja njëqarkore me ngritje të qarkullimit kthyes për mbështetjen e ngrohjes	1	1
3	Pajisja dyqarkore me 2 akumulues solar në punë paralele me akumuluesin	2	1
4	Pajisja dyqarkore me 2 akumulues solar me rregulluesin e akumuluesit prioritar	2	1
5	Pajisja dyqarkore me 2 fusha të kolektorëve dhe me 2 pompa të qarkullimit solar	1	2
6	Pajisja dyqarkore me 2 fusha të kolektorëve dhe me një pompë të qarkullimit solar	1	2
7	Pajisja dyqarkore me 2 fusha të kolektorëve, 2 akumulues solar me rregullues prioritar të akumulimit dhe me 2 pompa të qarkullimit solar	2	2
8	Pajisja dyaqrkore me 2 fusha të kolektorëve, 2 akumulues solar me rregullues të akumulimit prioritar dhe me një pompë të qarkullimit solar	2	2
9	Pajisje njëqarkore me ndërpreres bajpas	1	1
10	Pajisja dyqarkore me 2 akumulues solar, merregullues të akumulimit prioritar dhe me ndërpreresin bajpas	2	1
11	Pajisje dyqarkore me 2 akumulues solar në punë paralele të akumuluesit, me ndërprerës bajpas	2	1





Konfigurimi 1

Pajisja njëqarkore

- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e mëvonshme e akumuluesit inteligjent;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurimi 2

Pajisja një qarkore

- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e mëvonshme e akumuluesit inteligjent;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**
- **me rritjen e nivelit të temperaturës së mediumit të punës në tubin kthyes;**
- **me dirigjimin e valvulës mundësohet ndalja përkohësisht e punës së pajisjeve për prodhimin e nxehtësisë.**





Konfigurimi 2

Përzierja e shtresimeve

- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e mëvonshme e akumuluesit inteligjent;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurimi 3

- **Pajisjet dyqarkore**

- **Mundësohet puna paralele e akumuluesve;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurimi 4

Pajisjet dyqarkore

- **Mundësohet puna paralele e akumuluesve;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtesisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurini 4.1

Pajisje njëqarkore me 2 WT solar në një akumulues

- **Akumulimi i nxehtesisë në prioritet me akumuluesin shtresor BSP-SL;**
- **mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurimi 5

Pajisja dyqarkore

- **për 2 fusha të kolektorëve dhe për 2 pompa;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurim 6

Pajisjet dygarkore

- **për 2 fusha të kolektorëve, 1 pompë dhe 2 valvula;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurimi 7

- **Pajisjet dyqarkore**

- **për 2 fusha të kolektorëve, 2 pompa dhe 2 akumulues;**
- **Akumuluesi i nxehtesisë ka prioritet;**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**



Konfigurimi 8

- **Pajisjet dygarkore**

- **për 2 fusha të kolektorëve, 1 pompë me 2 valvula dhe 2 akumulues;**
- **akumulimi i nxehtësisë ka prioritet**
- **në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;**
- **nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;**
- **sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.**





Konfigurimi 9

- **Pajisjet dyqarkore**

- me ndërprerës Baj-Pas;
- në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e mëvonshme e akumuluesit inteligjent;
- në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;
- nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;
- sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.





Konfigurimi 10

- **Pajisjet dyqarkore**

- me ndërprerës Baj-Pas, 1 pompë dhe ventil përzierës trekahor;
- Akumuluesi i nxehtësisë ka prioritet;
- në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;
- nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;
- sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.





Konfigurim 11

Pajisjet dygarkore

- me dy ndërprerës Baj-Pas, 1 pompë dhe 2 valvula me motor;
- akumulimi i nxehtësisë ka prioritet;
- në lidhje me WRS është i mundshëm lidhja e akumuluesit shtresor me funksionin antilegional;
- nuk ka mundësi të regjistrimit të sasisë së nxehtësisë;
- sipas nevojës zgjidhet numri i rrotullimeve të pompës.

Parametrat BM	Parametrat BM- Solar	Emërtimet	Hapësira e programimit	Programimi mekanik	Programimi individual
SOL01	P01	Diferenca e ndaljes akumuluesi solar1	8K - 30K	10K	
SOL02	P02	Diferenca e ndaljes akumuluesi solar1	3K - 20K	5K	
SOL03	P03	Funksioni mbrojtes i kolektorëve	0(Aus) - 1(Ein)	0	
SOL04	P04	Temperatura kritike e kolektorëve	90°C - 150°C	110°C	
SOL05	P05	Temperatuara maksimale e kolektorëve	100°C - 150°C	130°C	
SOL06	P06	Temperatuara maksiamle e akumuluesve Akumuluesi solar 1	15°C - 90°C	60°C	
SOL07	P07	Kategorizimi i akumuluesit solar 1	0 - 8	0	
SOL08	P08	Regjistrimi i sasisë së nxehtësisë	0 - 2	0	
SOL09	P09	Sasia qarkulluese	0 - 99,5 l/Impuls l/min	1l/Impuls	
SOL10	P10	Zgjedhja e mesme	0 - 1	1	
SOL11	P11	Busspeisung	0 - 2	2	
SOL12	P12	Konfigurimi i pajisjeve	1 - 11	1	
SOL13	P13	Pompa me numër të rregulluar të sjelljeve	0(Aus) - 1(Ein)	0	
SOL14	P14	Diferenca e ndezjes akumuluesi solar 2	8K - 30K	10K	
SOL15	P15	Diferenca e ndaljes akumuluesi solar 2	3K - 20K	5K	
SOL16	P16	Temperatuara maksimale akumuluese Akumuluesi solar 2	15°C - 90°C	60°C	
SOL17	P17	Kategorizimi i akumuluesit solar 2	0 - 8	0	

	SOL18	P18	**Vlerat interne, mosndërrimi i programimit mekanik**	0-300s	0	
	SOL19	P19	Diferenca e aktivizimit ngritja e qarkullimit kthyes	8K - 30K	10K	
	SOL20	P20	Diferenca e ndaljes ngritja e qarkullimit kthyes	3K - 20K	5K	
	SOL21	P21	Akumuluesi prioritar	0 - 1	0	
	SOL22	P22	**Diferenca e aktivizimit puna paralele e akumuluesit**	20K – 60K	30K	
	SOL23	P23	Temperatura dalluese puna bajpas	8K - 50K	15K	
	SOL24	P24	**Funksioni i daljes A4**	0 - 2	0	
	SOL25	P25	Tem. e aktivizimit funksioni i temostatit	30°C - 90°C	50°C	
	SOL26	P26	Diferenca e ndaljes funksioni i termostatit	5K - 30K	10K	
	SOL27	P27	Funksioni i gypave të kolektorëve	0 - 2	0	
	SOL28	P28	Funksioni mbrojtes së ngricave	0(Aus) - 1(Ein)	0	
	SOL50	P50	Rele testi	1 - 5	1	
*	SOL70	-	Uji i ngrhtë-temperatuara momentale akumuluesi solar 1	Vetëm treguesi (°C)		
*	SOL71	-	Tem. e kolektorit fusha e kolektorit 1	Vetëm treguesi (°C)		
*	SOL72	-	Hyrja E1	(°C)		
*	SOL73	-	Hyrja E2: Qarkullimi Qarku solar	Vetëm treguesi l/min		
*	SOL74	-	Hyrja E3	Vetëm treguesi (°C)		

*SOL70 - SOL 74 Në rrafshin profesional të BM, tregohen edhe vlerat aktuale që në hyrje janë të kyçur sensorët. Mbulimi i hyrjeve E1 dhe E3 varësisht sipas funksionit të pajisjes.

Treguesi	Emri
A:01	Uji i ngrohtë, tem. momentale, akumuluesi solar 1(°C)
A:02	Temperatura maks. e ujit të ngrohtë, akumuluesi 1(°C)
A:03	Temperatuara e kolektorëve fusha e kolektorëve1(°C)
A:04	Tem. maksimale e kolektorit fusha e kolektorëve1(°C)
A:05	Hyrja E1 *
A:06	Hyrja E2: Qarkullimi, qarku solar (l/min)
A:07	Hyrja E3 *
A:08	Uji i ngrohtë tem. maksimale akumuluesi solar 2(°C)
A:09	Tem. maksimale e kolektorit fusha e kolektorëve2(°C)
A:10	Orë pune pompa e qarkut solar 1 (h)
A:11	Orë pune pompa e qarkut solar 2 (h)
A:12	Kapaciteti aktual (kW)
A:13	Kapaciteti aktual ditor (kWh)
A:14	Prodhimi total (Wh)
A:15	Prodhimi total (kWh)
A:16	Prodhimi total (MWh)
A:17	Statusi i mbushjes solare akumuluesi 1 (0 = jo e nevojshme, 1 = e nevojshme)
A:18	Statusi i mbushjes solare akumuluesi 2 (0 = jo e nevojshme, 1 = e nevojshme)

* Mbulimi i hyrjeve E1 dhe E3 varësisht sipas zgjedhjes së konfiguracionit në SM2

Gabimi në kod	Pengesa	Shkaku	Ndihma
FC64	Përçuesi i impulsit defekt	Përquesi i pimpulsit ose kablla defekt	Përçuesi i impulseve ose kablla të kontrollohen ose dhe të ndërrohen
FC71	Sensori solar i akumuluesit 1 defekt	Sensori ose kablla është defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC72	Sensori në hyrje E1 defekt	Sensori ose kaballa defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC73	Sensori në hyrje E3 defekt	Sensori ose kaballa defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC79	Sensori solar i fushës sëkolektorëve 1 defekt	Sensori ose kaballa defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC81	Gabimi EEPROM	Vlerat e parametrave qëndrojnëjashtë hap - sirës së lejuar	Kthimi i vlerave standard përmes ndërprerjeve të shkurta të tensionit dhe verfifikimit të vlerave

Përgatiti dhe sistemoi :

Wolfgang Pfisterer, ekspert ndërkombëtar

Mr.sc. Ismet Malsiu, - bashkë trajnues

Qendra kompetente për sistemet e kursimit të energjisë

Manual për montimin dhe përdorimin e Modulit Solar SM!

Durrës, 2013

Përmbajtja

Lista e figurave 4

Lista e tabelave 4

Udhëzimet e sigurisë 5

1.1 Normat/ Rregullat 6
1.1.1 Normat/ Vijat drejtuese 6
1.2 Instalimi/ Funksionalizimi 6
1.3 Shenjat udhëzuese 6
1.4 Rritja/Riparimi 6

Shpjegimi i nocioneve 8

1.5 Temperatura e kolektorëve 8
1.6 Temperatura e akumuluesit 8
1.7 Sasia qarkulluese 8
1.8 Prodhimi 8
1.9 Kapaciteti i ngrohjes 8
1.10 Akumuluesi solar 8
1.11 Akumulimi solar 8
1.12 Pompa e qarku solar 9
1.13 Shkurtesat / Përshkrimi i aparaturave 9

Përshkrimi i aparateve 9

1.14 Montimi 10
1.14.1 Montimi i modulit solar 10
1.15 Sensori i qarkullimit kthyes 12
1.16 Kapacitete për rekomandim dhe kapacitetet diagonale 12

Lidhja elektrike 13

Programimi i ndërprerësit DIP 14

1.17 Programimi i ndërprerësit DIP, Aktivizimi dhe ndalja e modulit solar 14
1.18 Aplikimet e mundshme të modulit 14
1.19 Lista e parametrave 15
1.20 Diferenca e aktivizimit 16
1.21 Diferenca e ndaljes 16
1.22 Funksioni mbrojtës i kolektorëve 17
1.23 Temperatura kritike e kolektorëve 17
1.23.1 Funksioni mbrojtës i kolektorëve 17
1.24 Ftohja gjatë kthimit 17
1.25 Temperatura maksimale e kolektorëve 17
1.26 Temperatura maksimale e akumulimit 18
1.27 Kategorizimi i akumuluesit 18
1.28 Regjistrimi i sasisë së ngrohtësisë 19
1.29 Vërtetimi i prodhimit përmes matjes së vlerave të qarkullimit 20
1.30 Vërtetimi i prodhimit në bazë të dhënies së vlerave të qarkullimit 20
1.31 Sasia e qarkullimit 20

Përshkrimi i parametrave / Funksioni shtesë 20

1.32 Zgjedhja e Mediumit 20
1.33 Releja testuese 21
1.34 Funksioni shtesë 21
1.34.1 Bllokimi i akumulimit shtesë 21
1.35 Bllokimi i funksionit antilegional 22
1.36 Funksioni antilegional i përditshëm 22
1.37 Funksioni antilegional njëherë në javë 22
1.38 Ruajtja e pompës nga bllokimi 22
1.39 Mbushja e vlerave standarde (Reset) 22
1.40 Temperatura maksimale e akumuluesit dhe e kolektorit mbi 24 h 23
1.41 Orët punuese 23
1.42 Ulja e vlerave 23
1.43 Gabimet në kode / Ndërrimi e siguresave 23
1.43.1 Gabimet në kode: 23
1.44 Ndërrimi i siguresave 24
1.45 Rezistenca e sensorëve 26
1.45.1 NTC Sensori solar akumuluesi (SFS) 26
1.46 PT1000 Sensori solar i akumuluesit (SFK) 27
1.46.1 Rezistenca e sensorit 27

Të dhëna teknike 27

Lista e figurave

Figura 1. Përshkrimi i aparateve solare....10
Figura 2. Montimi i modulit solar....10
Figura 3. Skema se si do të duket montimi i modulit solar....11
Figura 4. Montimi i kapakut të modulit....11
Figura 5. Skema e lidhjeve elektrike....13
Figura 6. Ndërprerësi DIP....14
Figura 7. Moduli solar SM1 brenda sistemit rregullator të Wolf-it....15
Figura 8. Moduli solar SM1 dhe moduli shërbyes BM-solar....15
Figura 9. Skema e kategorizimit të akumuluesit....19
Figura 10. Skema se si do te dukej procesi gjatë ndërrimit të siguresave....25

Lista e tabelave

Tabela 1. Lista e parametrave....16
Tabela 2. Rezistenca e sensorëve....26
Tabela 3. Rezistenca e sensorit PT 1000....27

Udhëzimet e sigurisë

Në përshkrimin që vijon, do të përdoren simbolet dhe shenjat këshilluese. Shumica e udhëzimeve kanë të bëjnë me mbrojtjen e njeriut dhe sigurinë e aparateve. Udhëzimet e sigurisë shërbejnë për mbrojtjen e njerëzve dhe për sigurinë e pajisjeve teknike.

„Udhëzimet e sigurisë‘‘ përmbajnë rregulla, të cilat duhet të zbatohen me përpikëri, për të evituar rrezikun apo lëndimin e njerëzve dhe për të shmangur dëmtimin e aparateve.

Rreziku nga tensioni elektrik në pjesët elektrike!
Kujdes: Para heqjes së veshjes të ndalet ndërprerësi i punës.

Asnjëherë mos i kapni pjesët elektrike dhe evitoni kontaktet me to kur ndërprerësi është i ndezur! Ekziston rreziku i ndonjë goditje të rrymës, i cili mund të jetë me pasoja për jetën ose mund të bëhet edhe shkaktar i vdekjes.

Edhe në vend-kyçjet që janë me ndërprerës të ndalur ka tension.

„Udhëzimi‘‘ përmban këshilla teknike, të cilat duhet të merren parasysh, në mënyrë që të evitohen dëmet dhe pengesat e funksionit në pajisje.

1.1 Normat/ Rregullat

1.1.1 Normat/ Vijat drejtuese

Aparati si dhe pjesët e rregullatorit përputhen me përcaktimet në vijim:

EG- Vijat drejtuese

- 2006/ 95/ EG Vijat drejtuese të tensionit të ulët - 2004/ 108/ EG EMV-Vijat drejtuese

EN- Normat

- EN 60730-1
- EN 55014-2
- EN 60529

1.2 Instalimi/ Funksionalizimi

- Instalimi dhe funksionalizimi i rregullatorit të ngrohjes dhe i pjesëve të kyçjes së aparaturës DIN EN50110-1 lejohet që të kryhet prej elektricistëve profesionist.
- Zbatimi i përcaktimeve vendore EVU dhe rregullave VDE
- Përcaktimi DIN VDE 0100 për rregullimin e pajisjeve të rrymës së fortë deri në 1000V
- Puna e pajisjeve elektronike DIN VDE 0105-100

Dirigjuesit vlejnë për Austrinë rregullat ÖVE si dhe për rregullat vendore të ndërtimit.

1.3 Shenjat udhëzuese

Largimi, tejkalimi ose heqja prej funksioni e pajisjeve siguruese dhe mbikëqyrjes është e ndaluar!

Pajisja lejohet të përdoret vetëm në gjendje të rregullt teknike. Pengesat dhe dëmtimet, shfaqja e të cilave e reduktojnë sigurinë, duhet të evitohen menjëherë.
Me rastin e programimit të temperaturës së ujit industrial mbi 60 ºC, duhet të sigurohet që të bëhet përzierja me ujë të ftohtë (rreziku nga djegia).

1.4 Rritja/Riparimi

- Funksionimi pa pengesa i pajisjeve elektrike, kërkon që ato të kontrollohen në periudha të rregullta kohore.

- Pengesat dhe dëmtimet lejohet të evitohen vetëm prej njerëzve profesionist dhe kompetent.
- Pjesët e prishura lejohet të zëvendësohen vetëm me pjesët origjinale të pajisjeve rezervë të Wolf-it.
- Kufizimet e vlerave të prishura të pajisjeve elektrike duhet t'i përmbahen (shih të dhënat teknike).

Nëse bëhen ndryshime teknike në rregullatorët e Wolf-it, si pasojë e së cilës mund të paraqiten dëmtimet, nuk japim garanci.

Shpjegimi i nocioneve

1.5 Temperatura e kolektorëve

Temperatura e kolektorëve është temperatura e mediumit, e cila prodhohet nga rrezatimi i diellit që bie mbi kolektor.
Temperatura e kolektorëve matet në vendin e daljes së lëndës qarkulluese nga kolektori, përkatësisht nga fusha e kolektorëve.

1.6 Temperatura e akumuluesit

Temperatura e akumuluesit, është temperatura, e cila matet në pjesën e poshtme të akumuluesit në nivel të këmbyesit të nxehtësisë.

1.7 Sasia qarkulluese

Sasia qarkulluese e lëngut është sasia e mediumit, e cila vihet lëvizja në qarkun solar, me ndihmën e pompës se qarkut solar. Sasia (e lëndës) qarkulluese jepet në l/min.

1.8 Prodhimi

Si prodhim konsiderohet sasia e ngrohjes, e cila prodhohet nga pajisja solare. Kjo gjë arrihet përmes sasisë qarkulluese dhe diferencës së temperaturës ndërmjet kolektorit dhe temperaturës (së lëndës) kthyese. Me këtë rast bëhet fjalë për një vlerë, e cila mblidhet ose zbritet për hapësirë kohore (ditë). Prodhimi shënohet në Wh, kWh ose MWh.

1.9 Kapaciteti i ngrohjes

Kapaciteti i ngrohjes paraqet vlerën se në çfarë mase është realizuar të prodhohet sasia e ngrohjes për një kohë të caktuar. Këtu bëhet fjalë për një vlerë momentale. Ajo shënohet në kW.

1.10 Akumuluesi solar

Akumuluesi solar konsiderohet akumuluesi, i cili mbushet nga pajisja solare.

1.11 Akumulimi solar

Nxehja e akumulimit përmes pompës së qarkut solar.

1.12 Pompa e qarku solar

Është pompa, e cila e vë në lëvizje masën e lëngut në qarkun solar.

1.13 Shkurtesat / Përshkrimi i aparaturave

Shkurtesat

SKP – Pompa e qarkut Solar
SFK – Sensori solar i kolektorit
SFS – Sensori solar i akumuluesit
RLF – Sensori (i lëngut) i qarkullimit kthyes
DFG – Përçuesi i masës së qarkulluese

Përshkrimi i aparateve

Moduli solar (SM1) përmban rregullatorin e një pajisjeje një qarkore me rregullatorin e dallimit të temperaturës.

Këtu krahasohen temperatura e akumuluesit dhe e kolektorëve dhe varësisht prej diferencës së temperaturës, pompa e qarkut solar aktivizohet për punë ose ndalet.

Sasia e ngrohtësisë mund të matet ose përmes vërtetimit të prodhimit duke bërë matjen e vlerave të qarkullimit të lëndës përmes rrjetit të orës për matjen e ngrohtësisë ose përmes vërtetimit të prodhimit duke regjistruar të dhënat e vlerave të lëndës qarkulluese (gjë për të cilën nevojitet sensori kthyes).

Me modulin shërbyes BM, BM-solar ose me modulin e ndarë në pjesa ISM1 me softuer komfort-soft, mund të ndërrohen parametrat dhe të tregohen vlerat dhe gabimet në kod. SM1 e posedon një vend prerës të e-BUS-it dhe në këtë mënyrë mund të integrohet në sistemin e rregullatorit të Wolf-it.



Figura 1. Përshkrimi i aparateve solare

1.14 Montimi

1.14.1 Montimi i modulit solar



Figura 2. Montimi i modulit solar

- Nxjerrja e modulit solar nga paketimi.
- Ç'montimi i modulit solar në Ø55mm ose vendosja e tij direkte në muri.
- Kyçja e modulit solar SM1 sipas planit instalues.

Udhëzim: Lidhjet e ndërtimit anësor për sensorët e akumuluesit, sensorët e kolektorëve, sensorët e lëndës së qarkullimit kthyes dhe për përçuesit e lëndës qarkulluese, të mos shtrihen së bashku në një lidhje me të njëjtin rrjet.



Figura 3. Skema se si do të duket montimi i modulit solar

Moduli shërbyes BM ose BM-solar, mund të montohet në modulin solar. Si alternativë, moduli shërbyes i vënë në muri, mund të përdoret si telederigjues. Gjatë lidhjes se modulit solar në sistemin e rregullatorit të Wolf-it, në të cilin veç më ekziston një modul shërbyes, nuk ka nevojë për një modul shërbyes tjetër të veçantë.



Figura 4. Montimi i kapakut të modulit

Më shumë të dhëna për këtë gjë mund të gjeni në udhëzuesin e përdorimit të modulit shërbyes BM ose BM-Solar.

Përçuesi i qarkullimit

Përçuesi i qarkullimit nevojitet për vërtetimin e prodhimit me vlerën e matur të lëndës qarkulluese. Kjo vihen në kapësen me etiketën DFG. Përçuesi i qarkullimit gjendet në rrjetin e orës për matjen e sasisë së ngrohtësisë.

1.15 Sensori i qarkullimit kthyes

Sensori i qarkullimit kthyes nevojitet për vërtetimin e prodhimit.
Të ,,vërtetimi i prodhimit përmes matjes së vlerës së qarkullimit‘‘ gjendet sensori iqarkullimit kthyes në rrjetin e orës për matjen e sasisë së ngrohtësisë.
Të ,,vërtetimi i prodhimit ku vlerat e qarkullimit deklarohen‘‘ mund të gjendet ky separat. Sensori i qarkullimit duhet të kyçet në kapëset me etiketën RLF.

1.16 Kapacitete për rekomandim dhe kapacitetet diagonale

H005VV 3x 1,0mm^2 Lidhja e rrjetit
H05VV 3x0,75mm^2 Pompa e qarkut solar
H05VV 2x0,5mm^2 Lidhja kryesore
H05VV 2x0,5mm^2 Lidhjet e sensorit deri 15m
H05VV 2x0,75mm^2 Lidhjet e sensorit deri 50m

Gjatë punës së shërbimit, e gjithë pajisja duhet të aktivizohet pa tension, për ndryshe ekziston rreziku i goditjeve të rrymës!

Lidhja elektrike



Figura 5. Skema e lidhjeve elektrike

Programimi i ndërprerësit DIP

1.17 Programimi i ndërprerësit DIP, Aktivizimi dhe ndalja e modulit solar

Në kuti të modulit solar gjendet ndërpreri DIP 4 polesh. Të mundësohet qasja pas largimit të pjesës së mbulesës.

Me ndërprerësin DIP moduli mund të aktivizohet („ON‘‘) dhe të ndalet („OFF‘‘). Të moduli i ndalur mbrojtja e pompës nga bllokimi i saj është ende aktive.

Ndërprerësi 2 dhe 3 nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe.

Me ndërprerësin 4 mund të mbushen vlerat standarde e të gjitha parametrave **(=Reset).** Për të realizuar këtë, ndërprerësi DIP 4 fillimisht duhet të vihet në „OFF‘‘ dhe pastaj të kthehet përsëri në „ON‘‘. Më këtë rast edhe vlerat, orët e punës dhe prodhimit kthehen mbrapa.

Pas Reset-it, të gjitha LED ndriçojnë për një kohë të shkurtër. Për ndryshe ndërprerësi DIP 4 duhet të qëndrojë „ON‘‘.

Programimi i mekanizimit:



Figura 6. Ndërprerësi DIP

1.18 Aplikimet e mundshme të modulit

Moduli solar SM1 mund të vihet në përdorim në kostelacione të ndryshme.

a) SM1 brenda sistemit rregullator të Wolf-it

Moduli solar SM1 mund të lidhet në një sistem të rregullatorit të Wolf-it. Shërbyesi i modulit solar pason pastaj me modulin solar BM me adresën 0. Po ashtu si shtesë mund të lidhet edhe një modul shërbyes BM-solar në SM1. Shërbimi mund të bëhet prej BM-së me adresën 0 dhe me BM-solar.



Figura 7. Moduli solar SM1 brenda sistemit rregullator të Wolf-it

Në rast së akumuluesi solar i është përcaktuar një BM tjetër, shërbimi mund të kryhet edhe prej atij moduli shërbyes. (krahaso përshkrimi i parametrave S0L07 / P07)

Udhëzim:

Brenda sistemit të rregullatorit të Wolf-it mund të lidhet vetëm **një** SM1.

b) SM1 (Stand-alone) me modulin shërbyes BM-solar

Moduli punon me modulin shërbyes BM-solar



Figura 8. Moduli solar SM1 dhe moduli shërbyes BM-solar

BM-solar mund të montohet me modulin solar SM1 ose mund të përdoret si teledirigjues.

c) SM1 (Sand-alone) pa modulin shërbyes

Ky modul solar punon pa modulin shërbyes. Për këtë shkak shërbimi dhe leximi i vlerave është i mundshëm vetëm me një sistem WRS të pritjes së largët.

Puna e pompës së qarkut solar dhe pengesat mund të vërehen në saje të LED-së në ballë të kutisë.

1.19 Lista e parametrave

Të gjithë parametrat për modulin shërbyes BM ose BM-solar mund të programohen.

Të BM (moduli shërbyes) ndërhyrja pason përmes rrafshit të dy të menysë shërbyese të rrafshët, „profesional → solar‘‘ (shih manualin shërbyes të BM).

Të BM-solar (moduli shërbyes solar), përmes komandës së tasit rrotullues mund të ndërrohet rrafshi i parametrit. (shih manualin shërbyes BM solar).

Parametrat BM	Parametrat BM-Solar	Emërtimi	Hapësira e programimit	Programimi mekanik	Programimi individual
SOL 01	P 01	Diferenca e e ndezjes	8K - 30K	10K	
SOL 02	P 02	Diferenca e ndaljes	3K - 20k	5K	
SOL 03	P 03	Funksioni mbrojtes i kolekt.	0 (ndalur) - 1 (aktiv)	0	
SOL 04	P 04	Temp. kritike e kolektorëve	90 °C - 150 °C	110°C	
SOL 05	P 05	Temp. maks. e kolektorëve	100 °C - 150 °C	130°C	
SOL 06	P 06	Temp. maks. akumuluese	15°C - 90 °C	60°C	
SOL 07	P 07	Kategroz. i akumuluesit-> BM	0 - 8	0	
SOL 08	P 08	Regjs. i sasisë së nxehtesisë	0 - 2	0	
SOL 09	P 09	Sasia e qarkullimit	0 - 99,5 l/mpuls l/min	1 l/Impuls 1 l/min	
SOL 10	P 10	Zgjedhja niveli mesatar	0 - 1	1	
SOL 11	P 11	Busspeisung	0 - 2	2	
SOL 50	P 50	Rele testi	1 - 5	1	

Tabela 1. Lista e parametrave

S0L01 / P01

1.20 Diferenca e aktivizimit

SM1 e mat temperaturën në kolektor dhe në pjesën e poshtme të akumuluesit në lartësi të këmbyesit të nxehtësisë solare.

Pompa e qarkut solar aktivizohet, kur tejkalohet temperatura e kolektorit, temperatura e akumuluesit përtej diferencës së temperaturës së aktivizimit.

Temperatura e kolektorit >= temperatura e akumuluesit + diferenca e aktivizimit > pompa aktivizohet

Për të siguruar një funksionim të dëshiruar, diferenca e aktivizimit mbahet gjithmonë për 5K mbi diferencën e ndaljes (diferenca e aktivizimit >= diferencën e ndaljes + 5K), edhe nëse është dhe një vlerë më e vogël.

S0L02 / P02

1.21 Diferenca e ndaljes

Nëse temperatura e kolektorëve dallon nga shuma e temperaturës së akumuluesit dhe të diferencës së ndaljes, atëherë pompa e qarkut solar ndalet.

Temperatura e kolektorëve < temperatura akumuluese + diferenca e ndaljes → pompa ndalet.

S0L3 / P03

1.22 Funksioni mbrojtës i kolektorëve

Nëse parametri S0L03 vendoset në 1, atëherë funksioni mbrojtës i kolektorit dhe ftohja kthyese janë aktiv.

S0L04 / P04

1.23 Temperatura kritike e kolektorëve

1.23.1 Funksioni mbrojtës i kolektorëve

Pompa e qarkut solar aktivizohet atëherë, kur temperatura e kolektorëve e tejkalon temperaturën kritike të kolektorëve. Pompa ndalet serish, nëse temperatura e kolektorëve = temperatura kritike e kolektorëve – 20K ose temperatura akumuluese > 95 ºC.

Kujdes:

Përmes funksionit mbrojtës të kolektorëve, akumuluesi solar vihet në temperatura dhe ngrihet në nivelit maksimal temperatura akumuluese (maksimale 95ºC). Gjatë aktivizimit të funksionit mbrojtës të kolektorit është mirë të sigurohet ujë i ftohtë për përzierjen e ujit industrial (Rrezik nga djegia prej ujit të nxehtë!).

1.24 Ftohja gjatë kthimit

Përmes funksionit mbrojtës të kolektorëve bëhet ngritja e temperaturës së akumulimit. Për ta reduktuar atë sërish, pasi temperatura e kolektorëve të këtë zbritur, lëshohet pompa e qarkut solar, kur Temperatura e kolektorit < temperatura akumuluese – 15K

S0L05 / P05

1.25 Temperatura maksimale e kolektorëve

Për të mbrojtur pajisjen, pompa e qarkut solar ndalet me rastin e tejkalimit të temperaturës maksimale.

Me këtë rast funksioni mbrojtës i kolektorëve nuk është më i efektshëm. Nëse temperatura e kolektorëve bie për 10K nën temperaturën maksimale, atëherë pompa aktivizohet përsëri (funksioni mbrojtës i kolektorëve bëhet prapë i efektshëm).

S0L06 / P06

1.26 Temperatura maksimale e akumulimit

Uji në akumulues ngrohet deri në temperaturën maksimale të akumuluesit. Mbushja e akumuluesit mbaron , kur temperatura e akumuluesit > temperatura maksimale e akumuluesit.

Rrezik nga përvëlimi me ujë të nxehtë!

Temperaturat mbi 60ºC mund të shkaktojnë djegie. Vëreni një mikser të ujit termik, në rast së temperatura e ujit duhet të vihet mbi 60 ºC.

S0L07 / P07

1.27 Kategorizimi i akumuluesit

Këta akumulues janë relevant **vetëm** me aktivizimin e modulit solar në një sistem të rregullatorit të Wolf-it.

Udhëzim:

> Tek pajisjet në të cilat ekziston vetëm një akumulues dhe i cili është i kyçur në aparatin e ngrohjes, nuk duhet të bëhet ndryshimi i programimit të aparatit.

Në një sistem të tërësishëm, mund të ekzistojnë deri 8 akumulues dhe më shumë module shërbyese BM. Në lidhje me modulin solar SM1, një akumulues vihet në funksion si një akumulues solar.

Për të siguruar funksionin „e bllokimit të rimbushjes së akumuluesit‘‘ ose „të bllokimit të funksionit antilegional‘‘ (shih përshkrimin e funksionit shtesë), duhet që akumuluesit solar t’i caktohet një modul shërbyes BM. Ky kategorizim vendoset përmes parametrit të 07:

S0L07 / P07 = 0: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 0
S0L07 / P07 = 1: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 1
S0L07 / P07 = 2: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 2
S0L07 / P07 = 3: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 3
S0L07 / P07 = 4: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 4
S0L07 / P07 = 5: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 5
S0L07 / P07 = 6: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 6
S0L07 / P07 = 7: Akumuluesi solar është kategorizuar në BM 7
S0L07 / P07 = 8: nuk ka kategorizim

Programimi i adresës në BM (modusi shërbyes) bëhet përmes ndërprerësit DIP (shih manualin e shërbimit të BM).

Shembulli për kategorizimin e akumuluesit:



Figura 9. Skema e kategorizimit të akumuluesit

Udhëzim: MM = Moduli i përzierjes

Në këtë shembull, akumuluesi solar i është kategorizuar modulit shërbyes me adresën 2 (BM2). Për këtë arsye duhet programuar:

S0L07/ P07 = 2

Programimi mund të kryhet përmes BM (modulit shërbyes) me adresë 0 (BM0) ose përmes BM-solar-it.

Një shërbyes së modulit solar pas kësaj është i mundshëm edhe një modul shërbyes.

S0L08 / P08

1.28 Regjistrimi i sasisë së ngrohtësisë

Për parametrin 08 mund të zgjidhet mes prodhimit të vërtetuar përmes matjeve ose dhënies së vlerave të qarkullimit:

S0L08 / P08 = 0: Regjistrimi i sasisë së ngrohtësisë është deaktivizuar
S0L08 / P08 = 1: Vërtetimi i prodhimit përmes matjes së vlerave të qarkullimit
S0L08 / P08 = 2: Vërtetimi i prodhimit në bazë të dhënies së vlerave të qarkullimit

1.29 Vërtetimi i prodhimit përmes matjes së vlerave të qarkullimit

Vërtetimi i prodhimit përmes matjes së vlerave të qarkullimit bëhet me anë të sensorit të kolektorit, përmes përçuesit të lëngut dhe përmes sensorit të qarkullimit kthyes. Në këtë mënyrë, bëhet matja e saktë e prodhimit dhe e kapacitetit të ngrohjes, gjithmonë në vlerat e sakta të lëngut qarkullues. Për këtë gjë nevojitet rrjeti i orës për matjen e sasisë së ngrohtësisë (Lloji nr. 2744392).

1.30 Vërtetimi i prodhimit në bazë të dhënies së vlerave të qarkullimit

Të vërtetimi i prodhimit në bazë të dhënies së vlerave të qarkullimit, duhet që së pari lënda qarkulluese të vërtetohet dhe pastaj të tregohet. Vërtetimi i prodhimit pas kësaj pason përmes kësaj vlere, të sensorit të kolektorit dhe të sensorit të qarkullimit kthyes (Lloji nr. 2792022). Sensori i qarkullimit kthyes duhet të vihet afër grupit të pompave të armaturës. Në rast të ndërrimit të lëngut të qarkullimit, nuk është e mundshme vërtetimi i saktë i prodhimit.

S0L0 / P 09

1.31 Sasia e qarkullimit

Për vërtetimin e prodhimit duhet të jepet vlera e vërtetuar e qarkullimit, përkatësisht vlera e impulseve të përçuesit të qarkullimit të përdorur.

Dhënia e këtyre vlerave është e varur nga programimi i parametrit 08:

S0L08 / P08 = 1:

Është vlera e impulseve të përçuesit të përdorur për l/impuls (sasia qarkulluese pro impuls) që duhet të jepet.

Si programim i mekanizimit të punës, më herët është përcaktuar vlera e duhur e përdorimit të rrjetit të orës së sasisë së nxehtësisë.

S0L08 / P08) = 2:
Duhet të jepet vlera e vërtetuar e qarkullimit për l/min.

Përshkrimi i parametrave / Funksioni shtesë

S0L10 / P10

1.32 Zgjedhja e Mediumit

Këtu duhet të përzgjidhet se a duhet përdorur uji medium apo lëngu specifik i Wolf-it për bartjen e nxehtësisë.

S0L10 / P10 = 0: Medium = ujë
S0L10 / P10 = 1: Medium = lëngu specifik i Wolf-it për bartjen e nxehtësisë (Antifrizi)

S0L11 / P11

Programimi i mekanizimit të punës = 2, parametrat nuk bën të ndryshohen. Në rast së ky parametër ndërrohet gabimisht pa e vërejtur, atëherë në BMS nuk shfaqet asgjë në ekran. Në këtë rast ndërprerësi DIP 4 të kthehet në ,,OFF‘‘ dhe pastaj të kthehet serish në ,,ON‘‘ (Reset).

S0L50 / P50

1.33 Releja testuese

Gjatë aktivizimit të këtij parametri, pompa e qarkut solar dirigjohet për shkaqe të testimit. Kusht për këtë është, që temperatura e kolektorëve të është më e ulët sesa temperatura maksimale e kolektorëve (P05) (Temperatura e kolektorëve < temperatura maksimale e kolektorëve)

Kujdes

Nëse temperatura e kolektorëve është më e madhe sesa vlera e parametrave 05 ,,temperatura maksimale e kolektorëve‘‘ (programimi i mekanizimit të punës 130 ºC), atëherë as pompa e kolektorëve të rele testit nuk dirigjohet. Pjesët përbërëse të pompës në këtë mënyrë ruhen nga temperatura tepër e lartë.

1.34 Funksioni shtesë

1.34.1 Bllokimi i akumulimit shtesë

,,Njësia komanduese e sistemit solar‘‘

Ky funksion është vetëm atëherë i efektshëm, nëse moduli solar është përdoret duke qenë i përfshirë brenda sistemit të rregullatorit të Wolf-it.

Nëse në 24 orët e fundit para orës 14, një mbushje solare të ketë përfunduar së mbushuri me sukses (në SM1 të matjes së temperaturës së akumuluesit > temperatura e duhur e akumuluesit), duhet që temperatura standarde e akumuluesit të vihet në BM (modulin shërbyes) përkatës, menjëherë në temperaturë të ujit të ngrohtë në nivel minimal.

Nëse brenda 24 orëve nuk vjen deri të mbushja e suksesshme solare, atëherë akumuluesi rregullohet përsëri nga aparati i ngrohjes duke e sjellë atë në temperaturën standarde. Mbushja e suksesshme solare mund të matet në BM (modulin shërbyes) dhe në BM- solar (modulin shërbyes solar) të caktuar.

1.35 Bllokimi i funksionit antilegional

Ky funksion është vetëm atëherë i efektshëm, nëse moduli solar është përdoret duke qenë i përfshirë brenda sistemit të rregullatorit solar të Wolf-it.

Nëse prodhimi solar, që regjistrohet nga sensori i akumuluesit solar të akumuluesit solar (SFS), mbahet mbi një orë në 65 ºC, atëherë funksioni antilegional ndalet përmes aparatit të ngrohjes. Bllokimi i funksionit antilegional të aparatit të ngrohjes, lajmërohet në BM (modulin shërbyes) të caktuar.

Për të siguruar këtë funksion, duhet që temperatura maksimale e akumuluesit (S0L06 / P06) të programohet mbi 65 ºC: S0L06 / P06 > **65ºC!**

Në aparatin e ngrohjes, përmes modulit shërbyes BM mund të zgjidhet funksioni antilegional. Në këtë rast mund të zgjidhet ndërmjet aktivizimit ditor ose javor.

1.36 Funksioni antilegional i përditshëm

Funksioni antilegional bllokohet përmes aparatit të ngrohjes, nëse deri në ora 18:00 përmes sensorit të akumuluesit solar, temperatura e akumuluesit, e cila regjistrohet përmes sensorit të akumuluesit solar (SFS), është mbajtur për një orë mbi temperaturë 65 ºC.

1.37 Funksioni antilegional njëherë në javë

Funksioni antilegional bllokohet përmes aparatit të ngrohjes, nëse në ditën e aplikimit të funksionit antilegional ose një ditë më herët temperatura e akumuluesit, e cila regjistrohet përmes sensorit të akumuluesit solar (SFS), është mbajtur për një orë mbi temperaturë 65 ºC.

1.38 Ruajtja e pompës nga bllokimi

Për të parandaluar bllokimin e pompës së qarkut solar si shkak kohërave të gjata të pushimit, pompa vihet në funksion pas më shumë së 24 orëve të pushimit, rregullisht njëherë në ora 12:00 për rreth 5s. Ky funksion nuk është i efektshëm, nëse temperatura maksimale e kolektorëve (S0L05 / P05) është tejkaluar.

1.39 Mbushja e vlerave standarde (Reset)

Për t'i plotësuar sërish këto vlera standarde, duhet që ndërprerësi DIP të vihet në „OFF‘‘ dhe pastaj të kthehet prapë në „ON‘‘. Vlerat për orët e punës dhe prodhimi kthehen po ashtu mbrapa.

1.40 Temperatura maksimale e akumuluesit dhe e kolektorit mbi 24 h

Bëhet përmbledhja maksimale e temperaturës së akumuluesit dhe e kolektorëve për një ditë (prej orës 0:00 deri në 24:00 orë). Këto vlera ruhen rregullisht në ora 24:00 dhe mund të shihen pastaj në BM (moduli shërbyes) ose në BM-solar (moduli shërbyes solar).

1.41 Orët punuese

Orët e punës përmblidhen dhe ruhen në pompën e qarkut solar. Këto vlera tregohen në BM (moduli solar) dhe në BM-solar (moduli shërbyes solar).

1.42 Ulja e vlerave

Vlerat e orëve të punës, prodhimin ditor dhe prodhimin total mund të ulën përmes BM (modulit shërbyes) dhe BM-solar (modulit shërbyes solar) duke prekur tastën rrotulluese për së paku 10s.

1.43 Gabimet në kode / Ndërrimi e siguresave

1.43.1 Gabimet në kode:

Nëse në SM1 vërehet një pengesë, atëherë bën dritë treguesi i kuq LED dhe shfaqet gabimi në kod i modulit solar të BM (modulin shërbyes) ose i BM-solar (modulin shërbyes solar) përkatës. Gjatë përdorimit të SM1 në një sistem të rregullatorit të Wolf-it si shtesë, shfaqet edhe gabimi në kod në modulin shërbyes BM me adresë 0.

Këto pengesa mund të shfaqen në SM1:

Gabimi në kod	Pengesa	Shkaku	Zgjidhja
FC64	Përçuesi i impulsit defekt	Përçuesi ose kablla është defekt	Përçuesi i impulseve ose kablla të kontrollohen ose edhe të ndërrohen
FC71	Sensori i akumuluesit solar defekt	Sensori ose kablla është defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC72	Sensori i qarkullimit kthyes defekt	Sensori ose kablla është defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC79	Sensori solar i kolektorit defekt	Sensori ose kablla është defekt	Sensori dhe kablla të verifikohen ose të ndërrohen
FC81	Gabimi EEPROM	Vlerat e parametrit qëndrojnë jashtë hapësirës së lejuar	Kthimi i vlerave standard përmes ndërprerjeve të shkurta të tensionit dhe vërifikimit të vlerave

1.44 Ndërrimi i siguresave

Në qoftë se SM1 nuk tregon kurrfarë funksioni dhe nuk shfaqet asnjë tregues LED edhe pse ekziston tensioni në rrjet, atëherë duhet të verifikohet siguresa e aparaturës dhe eventualisht edhe të ndërrimi.

Udhëzim:

> Në rast se përdoret sistemi i rregullatorit të Wolf-it, atëherë treguesi i një moduli shërbyes BM ose BM solar megjithatë qëndron, pasi kjo furnizohet përmes lidhjes së e-Bus-it drejt komponentëve të tjera të rregullatorit.

Para hapjes së kutisë, duhet të ndahet moduli solar nga tensioni i rrjetit!

Kjo parashihet të bëhet gjatë ndërrimit të siguresave:

1. Ndalja e tensionit të rrjetit
2. Largimi i kapakut mbyllës përmes largimit të dy dadove
3. Largimi i pjesës së sipërme të kutisë me kaçavide
4. Siguresa gjendet në të majtë të shkallës së plakës nën trafo (siguresa e imët 5x20/6,3 A/m)



Figura 10. Skema se si do te dukej procesi gjatë ndërrimit të siguresave

1.45 Rezistenca e sensorëve

1.45.1 NTC Sensori solar akumuluesi (SFS)

Rezistenca e sensorëve Sensori i qarkullimit kthyes (RLF)

Temp. ºC	Rezistenca Ohm	Temp. ºC	Rezistenca Ohm	Temp. ºC	Rezistenca Ohm	Temp. ºC	Rezistenca Ohm
-21	51393	14	8233	49	1870	84	552
-20	48487	15	7857	50	1800	85	535
-19	45762	16	7501	51	1733	86	519
-18	43207	17	7162	52	1669	87	503
-17	40810	18	6841	53	1608	88	487
-16	38560	19	6536	54	1549	89	472
-15	36447	20	6247	55	1493	90	458
-14	34463	21	5972	56	1438	91	444
-13	32599	22	5710	57	1387	92	431
-12	30846	23	5461	58	1337	93	418
-11	29198	24	5225	59	1289	94	406
-10	27648	25	5000	60	1244	95	393
-9	26189	26	4786	61	1200	96	382
-8	24816	27	4582	62	1158	97	371
-7	23523	28	4388	63	1117	98	360
-6	22305	29	4204	64	1078	99	349
-5	21157	30	4028	65	1041	100	339
-4	20075	31	3860	66	1005	101	330
-3	19054	32	3701	67	971	102	320
-2	18091	33	3549	68	938	103	311
-1	17183	34	3403	69	906	104	302
0	16325	35	3265	70	876	105	294
1	15515	36	3133	71	846	106	285
2	14750	37	3007	72	818	107	277
3	14027	38	2887	73	791	108	270
4	13344	39	2772	74	765	109	262
5	12697	40	2662	75	740	110	255
6	12086	41	2558	76	716	111	248
7	11508	42	2458	77	693	112	241
8	10961	43	2362	78	670	113	235
9	10442	44	2271	79	649	114	228
10	9952	45	2183	80	628	115	222
11	9487	46	2100	81	608	116	216
12	9046	47	2020	82	589	117	211
13	8629	48	1944	83	570	118	205

Tabela 2. Rezistenca e sensorëve

1.46 PT1000 Sensori solar i akumuluesit (SFK)

1.46.1 Rezistenca e sensorit

Temp. ºC	Rezistenca Ohm	Temp. ºC	Rezistenca Ohm	Temp. ºC	Rezistenca Ohm	Temp. ºC	Rezistenca Ohm
-30	882	20	1077	70	1271	140	1535
-20	921	30	1116	80	1309	160	1610
-10	960	40	1155	90	1347	200	1758
0	1000	50	1194	100	1385	-	-
10	1039	60	1232	120	1461	-	-

Tabela 3. Rezistenca e sensorit PT 1000

Të dhëna teknike

Tensioni furnizues.....230 VAC (+10/-15%) / 50 Hz

Kapaciteti absorbues elektronik.....< 5 VA

Kapaciteti maksimal absorbues i motorit përzierës…….30 VA

Kapaciteti maksimal absorbues për çdo dalje prej pompes……..250 VA

Lloji mbrojtës sipas EN 60529……....IP 30

Klasa mbrojtese.....I I

Temperatuara e ambientit të punës…….....0 deri 50 ºC

Temperatura e ambientit të depos.....-30 deri +60 ºC

Përmbajtja e të dhënave.....EEPROM i permanent

Sigurimi.....Sigurimi i detajuar 5x20 / 6,3A/M

KONTROLLI PAMOR

Nr	Emër Mbiemër	Pozicionimi i kaldajës	Pozicionimi i pompës qark.	Pozicionimi i armat. mbrojtëse			
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							
16							
17							
18							
19							
20							

KONTROLLI I PERMASAVE

Nr	Emër Mbiemër	Emërtimi					
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							
16							
17							
18							
19							
20							

KONTR. I PERMASAVE

Nr	Emertimi	PO	JO
1	Funksionimi i kaldajës		
2	Funksionimi i pompës qarkulluese		
3	Funksionimi i valvolës 3 kahore me		
	servomotor.		
4	Reagimi i sensorëve.		
5	Kontrolli i tërësishem.		
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			

Montage- und Bedienungsanleitung

Regelung R1



Wolf GmbH · Postfach 1380 · 84048 Mainburg · Tel. 08751/74-0 · Fax 08751/741600 · Internet: www.wolf-heiztechnik.de
WOLF Klima- und Heiztechnik GmbH · Eduard-Haas-Str. 44 · 4034 Linz · Tel. 0732/385041-0 · Internet: www.wolf-heiztechnik.at

Art.-Nr.: 3061468_0910 Änderungen vorbehalten

D AT

Inhaltsverzeichnis

Sicherheitshinweise 3

Normen / Vorschriften 4

Montage / Elektrische Arbeiten 5-6

Inbetriebnahme 7

Regelung / Funktion / Bedienung 8-10

Regelungsparameter anzeigen / ändern 11

Fachmannebene Parameter 12-25

Betriebsart / Status HG 26

Soll- / Istwerttemperatur Anzeige 27

Einstellung eBus-Adresse 28

Einstellprotokoll Parameter 29

Umstellung STB 30

Fühlerwiderstände 31

Schaltplan Kesselregelung R1 32

Technische Daten 33

Störmeldungen 34

Stichwortverzeichnis 35-36

In dieser Beschreibung werden die folgenden Symbole und Hinweiszeichen verwendet. Diese wichtigen Anweisungen betreffen den Personenschutz und die technische Betriebssicherheit.

„Sicherheitshinweis“ kennzeichnet Anweisungen, die genau einzuhalten sind, um Gefährdung oder Verletzung von Personen zu vermeiden und Beschädigungen am Gerät zu verhindern.

Gefahr durch elektrische Spannung an elektrischen Bauteilen! Achtung: Vor Abnahme der Verkleidung Betriebsschalter ausschalten.

Greifen Sie niemals bei eingeschaltetem Betriebsschalter an elektrische Bauteile und Kontakte! Es besteht die Gefahr eines Stromschlages mit Gesundheitsgefährdung oder Todesfolge.

An Anschlussklemmen liegt auch bei ausgeschaltetem Betriebsschalter Spannung an.

Achtung „Hinweis“ kennzeichnet technische Anweisungen, die zu beachten sind, um Schäden und Funktionsstörungen am Gerät zu verhindern.



Installation / Inbetriebnahme

Die Kesselregelung entspricht folgenden Bestimmungen:

EG-Richtlinien

- 2006/95/EG Niederspannungsrichtlinie
- 2004/108/EG EMV-Richtlinie

DIN / EN - Normen

EN 60335-1, EN 60730-2-9, EN 14597,
DIN 3440, EN 50165, EN 55014-1

Für die Installation sind nachfolgende Vorschriften, Regeln und Richtlinien zu beachten

- Die Installation und Inbetriebnahme der Heizung
- Die örtlichen EVU-Bestimmungen
- DIN VDE 0100 Bestimmungen für das Errichten von Starkstromanlagen bis 1000V
- DIN VDE 105 Betrieb von elektrischen Anlagen
- EN50156 Elektrische Ausrüstung von Feuerungsanlagen
- EN 12828 Heizungssysteme in Gebäuden

Bestimungsgemäße Verwendung

Die Wolf Regelung R1 wird ausschließlich in Verbindung mit Wolf Heizgeräten eingesetzt. Die Regelung R1 ist mit einem Temperaturregler/ -wächter und einem Sicherheitstemperaturbegrenzer ausgestattet. Die Regelung steuert einen einstufigen Brenner. Die Kesselsolltemperatur ist einstellbar von 38-90°C.
Die Regelung R1 kann mit einem Bedienmodul BM zur witterungsgeführten Temperaturregelung mit Zeitprogramm erweitert werden.

Mitgeltende Unterlagen

Montage- und Bedienungsanleitung des Heizgerätes
Anleitungen aller verwendeten Zubehöre.

Warnhinweise

- Das Entfernen, Überbrücken oder Außerkraftsetzen von Sicherheits- und Überwachungseinrichtungen ist verboten!
- Die Anlage darf nur in technisch einwandfreiem Zustand betrieben werden. Störungen und Schäden, die die Sicherheit beeinträchtigen, müssen umgehend beseitigt werden.

- Bei Einstellung der Brauchwassertemperatur über 60°C bzw. bei Aktivierung der Legionellenschutzfunktion (65°C) ist für eine entsprechende Kaltwasserbeimischung zu sorgen (Verbrühungsgefahr).

Wartung / Reparatur

- Die einwandfreie Funktion der elektrischen Ausrüstung ist in regelmäßigen Abständen zu kontrollieren.
- Störungen und Schäden dürfen nur von Fachkräften beseitigt werden.
- Schadhafte Bauteile dürfen nur durch original Wolf-Ersatzteile ersetzt werden.
- Vorgeschriebene elektrische Absicherungswerte sind einzuhalten (siehe Technische Daten).

Achtung Werden an Wolf-Regelungen technische Änderungen vorgenommen, übernehmen wir für Schäden, die hierdurch entstehen, keine Gewähr.

Montage



Bei der Montage der Regelung ist zu beachten, dass die Fühlerkapillaren nicht geknickt oder verdreht werden!
Bauseitige Leitungen für Fühler und Fernbedienung nicht zusammen mit Netzleitungen verlegen.
Elektrische Verdrahtung gemäß Schaltplan.

Hinteren Regelungsdeckel nach Lösen der beiden Schrauben öffnen.

Brennerzuleitung
durch die Öffnung in der Regelungskonsole (links/rechts) führen, je nach Schwenkrichtung der Kesseltüre.

Kesselfühler
in beliebige Öffnung der Tauchhülse des Kessels stecken

Sicherheitstemperaturbegrenzer
Fühlerkapillare in beliebige Öffnung der Tauchhülse des Kessels stecken

Schutzleiteranschluss
an die Regelungskonsole stecken

Thermometer für Kesseltemperaturanzeige
in beliebige Öffnung der Tauchhülse des Kessels stecken

Elektrische Arbeiten



Hinweis

Alle eventuell nicht benötigte Stecker in die Steckerleiste stecken. Farbcodierung beachten.

Netzanschluss

